

## V E N D I M

### “PËR VËNIE SEKUESTRO PREVENTIVE”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga :

GJYQTARE : REZARTA BALLIU (VIGANI)

asistuar prej sekretares gjyqesore Loreta Merepeza, sot në datë 07.04.2017 mori në shqyrtim, kërkesën penale me :

KËRKUES : Prokuroria, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga prokurori Gjergji Tako .

OBJEKTI : Vendosja e sekuestros preventive .

BAZA LIGJORE: Neni 274/1 i K.Pr.Penale.

- Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën e prokurorit i cili kërkoi – vendosjen e sekuestros preventive dhe pasi e bisedoi dhe shqyrtoi çështjen në tërësinë e saj,

## V Ë R E N

Se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e materialeve të ardhura , ka regjistruar proçedimin penal me Nr.2234 të vitit 2017, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal .

Nga hetimet paraprake ka rezultuar se, shtetasi N. K. me cilësinë e administratorit të shoqërisë tregtare “P... P...” sh.a., ka bërë një kallzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datë 12.12.2016, në lidhje me veprimtarinë e Përmbaruesit Gjyqësor Privat Altin Vako.

Ky përmbarues, në datë 30.11.2016 ka nxjerrë urdhërin Nr.... Prot “Urdhër për Vënien e Sekuestros Konservative të Magazinës Fiskale”, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Departamentit të Akcizës , ndaj debitorit ,shoqërisë “P... P...” sh.a., për llogari të kreditorit, shoqërisë “S... O... & D...” sh.a.

Kallzuesi pretendon se vendosja e masës së bllokimit të magazinës fiskale është një veprim i kundraligjshëm i përmbaruesit gjyqësor privat Altin Vako, pasi shoqëria “P... P...” sh.a., nuk mund që të përmbushë më objektin e veprimtarisë së saj, që është prodhimi dhe shitja e hidrokarbureve dhe pagesat e detyrimeve që ka shoqëria ndaj të tretëve, duke bërë në këtë mënyrë që shoqëria “P... P...” sh.a., të shkojë drejt procedurës së falimentimit .

Gjithashtu, në materialin kallzues pretendohet se duke bllokuar veprimtarinë prodhuese dhe shitëse të shoqërisë, shoqëria “P... P...” sh.a., nuk është në gjendje të përmbushë marrëveshjen e lidhur me shoqërinë A... sh.a., si dhe t’i përmbahet termave të kësaj marrëveshje .

Sipas kallzuesit, shoqëria “P... P...” sh.a., i është drejtuar gjykatës në lidhje me këtë urdhërin Nr.1665 Prot datë 30.11.2016 të nxjerrë nga përmbaruesi gjyqësor Altin Vako dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e saj Nr.676 ,në datë 03.02.2017 ka vendosur :

Pranimin e ankimit të palës paditëse debitore shoqërisë “P... P...” sh.a.

Anullimin e veprimit përbarimor të Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako, me Nr.1665 Prot datë 30.11.2016 “Urdhër për vendosje të sekuestros konservative të magazinës fiskale drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Departamentit të akcizës”, si të pabazuar në ligj .

Edhe pas dhënies së këtij vendimi të gjykatës, pavarësisht se nuk është i formës së prerë, përmbaruesi gjyqësor ka vazhduar procedurën përbarimore me veprime ekzekutuese Nr.... Prot dhe Nr.... Prot të datës 24.03.2017 .

Sa sipër, organi i akuzës në mbështetje të nenin 274/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 36 të Kodit Penal , vlerëson të nevojshme vendosjen e sekuestros preventive mbi dosjet përbarimore të Përmbaruesit gjyqësor privat Altin Vako , duke qenë se vazhdimi nga ana e tij i veprimeve përbarimore mund të rëndojë dhe zgjasë pasojat e veprës penale për të cilën është regjistruar ky procedim penal .

Gjykata , referuar provave shkresore bashkëlidhur kerkesës çmon se kërkesa mbështetet në ligj e prova dhe duhet të pranohet . Ajo mbështetet në nenin 274 pika 1, 2 të Kodit të Procedurës Penale.

Përsa mësipër , gjykata në përfundim të shqyrtimit të kërkesës çmon se, kërkesa e prokurorit, plotëson kushtet dhe kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 274 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 36 të Kodit Penal, për vendosjen e sekuestros preventive .

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata në bazë të nenit 274 të K.Pr.Penale dhe nenit 36 të K.Penal,

### V E N D O S I

- Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si të bazuar në ligj dhe në prova.
- Vendosjen e sekuestros preventive për dosjet përmbarimore nga Nr.821-840 të datës 23.11.2016 të Përmbaruesit Gjyqësor Privat Altin Vako.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit në Gjykatën e Apelit Tiranë.
- U shpall sot me datë 07.04.2017 Tiranë.

SEKRETARE

Loreta MEREPEZA

GJYQTARE

Rezarta BALLIU (VIGANI)